



Përgëzime mbi vendimin tuaj për të emigruar në Australi. Ju urojmë gjithë të mirat dhe shpresojmë që do të jeni të lumtur në shtëpinë tuaj të re.

Ky formular paraqet një përmbledhje të shkurtër të disa aspekteve kryesore që duhet të merrni në konsideratë gjatë përgatitjeve për fillimin e një jete të re në Australi. Për shumë emigrantë burimet kryesore të informacionit rreth Australisë janë të afërmit, shokët dhe kontaktet aty. Megjithatë, sa më shumë dihet rreth Australisë, aq më i lehtë do të jetë procesi i vendosjes aty.

Faqet e internetit të titulluara *Jeta në Australi* të përgatitura nga Departamenti i Imigracionit dhe Nënshtrësisë (departamenti) gjenden tek www.immi.gov.au/living-in-australia/ dhe ato përmbajnë më shumë informacione mbi vendosjen në Australi si dhe përfshijnë shërbimet e ngritura posaçërisht për emigrantët e sapoardhur.

Broshurat e titulluara *Fillimi i Jetës në Australi* janë prodhuar për çdo shtet dhe provincë territoriale dhe janë të disponueshme në Anglisht dhe në 37 gjuhë të komunitetit. Ato përmbajnë informacione të detajuara rreth shërbimeve për emigrantët e ardhshëm dhe ata të sapoardhur, dhe janë të disponueshme nga faqet e internetit tek

www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/

Shoqëria e shumëllojshme Australiane

Australia është një shoqëri tolerante dhe e shumëllojshme me njerëz nga kultura, gjuhë dhe prejardhje fetaro-etnike të ndryshme. Australianët vijnë nga të gjitha anët e botës. Rreth 45% e Australianëve kanë lindur jashtë shtetit ose kanë një prind që ka lindur jashtë shtetit.

Australianët praktikojnë një variacion të gjerë të fesë. Çdo njeri në Australi është i lirë të shprehë dhe të mirëmbajë traditat e veta kulturore dhe fetare, brenda ligjit, dhe në të njëjtën kohë të marrë pjesë si një Australian. Fillimisht, ju ndoshta nuk jeni mësuar me një shumëllojshmëri të tillë, por në qoftë se ju jeni i hapur dhe tregoni respekt ndaj njerëzve, ideve dhe traditave të tyre, ju do të keni mundësinë të përshtateni dhe të jeni të suksesshëm në jetën tuaj të re.

Liria dhe barazia që ne gëzojmë në Australi varet nga çdo njeri që të përmbushë përgjegjësitë e tyre. Ne presim prej jush që të jeni besnik ndaj Australisë dhe të përkrahni mënyrën demokratike të jetës tonë dhe të ndihmoni që Australia të ruajë traditat e mirëpritjes, gjithëpërfshirjes dhe drejtësisë për të gjithë. Këtu ka ligje federale, shtetërore dhe territoriale të cilat parandalojnë diskriminimin mbi bazat e (racës, gjinisë, paaftësisë apo moshës) dhe në fushën e jetës publike (si punësimin, arsimimin, akomodimin, e drejta për shërbimet dhe të mirat materiale, dhe veprimet e qeverisë).

Anglishtja është gjuha kombëtare, e megjithatë në Australi fliten rreth 300 gjuhë duke përfshirë edhe gjuhët indigjene. Në qoftë se ju nuk flisni Anglisht, ju inkurajojmë që të mësoni sa më parë që të jetë e mundur pas ardhjes në Australi. Ju mund të keni të drejtë që të ndiqni klasat e mësimi falas nëpërmjet Programit të Anglishtes për Imigrantët e Rritur (AMEP). Detajet rreth këtij programi gjenden në faqen 4.

Doganat dhe Karantina

Zyra e përfaqësisë Australiane mund të japë informacione rreth rregullave të doganës dhe karantinës Australiane. Aty mund të mësohet se çfarë mund dhe s'mund të sillen në Australi, kushtet specifike rreth sjelljes së pajisjeve shtëpijake, kafshëve / produkteve të kafshëve, dhe rreth detyrave të doganës. Për më shumë informacione drejtohuni tek www.customs.gov.au

Paratë dhe Banka

Përpara se të udhëtoni, ju duhet të merrni me vete çeqe udhëtimit ose valuta të tjera të shkëmbyeshme si dollarë Amerikanë ose Australianë. Valutat e huaja mund të shkëmbehen me dollarë Australianë në shumë aeroporte ndërkombëtare të Australisë.

Njerëzit zakonisht i mbajnë paratë e tyre në bankë ose institucione të tjera financiare. Në qoftë se hapni një llogari me një nga këto institucione brenda 6 javëve së arrijtes tuaj, ju zakonisht keni nevojë vetëm për pashaportën. Mbas 6 javësh, për të hapur një llogari do të keni nevojë për dokumente të tjerë identifikimi.

Transporti

Ju do të keni nevojë që të gjeni transport nga aeroporti deri tek akomodimi juaj. Taksitë dhe autobuzët ndodhen në të gjithë aeroportet ndërkombëtare dhe në shumë aeroporte të tjera.

Për drejtimin e makinës nevojitet leja Australiane e drejtimit të automjeteve. Leja ndërkombëtare mund të pranohet për një kohë të shkurtër. Kontaktoni departamentin e transportit të shtetit ose territorit më të afërt për të marrë informacion rreth marrjes së lejes së drejtimit të automjeteve. Numërori telefonik lokal rradhiti agjensitë përkatëse me detajet e kontaktimit.

Banimit

Për të marrë shtëpi me qira/apo për të blerë një shtëpi/apartament, ju mund të gjeni se çfarë është e disponueshme nëpërmjet reklamimeve në gazeta, në internet ose nëpërmjet agjentëve të pasurive të paluajtshme. Pagimi i një depozite, e barabartë me një qira mujore, plus një muaj pagesë qira si paradhënie është një praktikë e zakonshme kur merrni shtëpi me qira. Gjetja e banesave në Australi është e vështirë dhe qiraja kushton shtrenjtë.

Shkollat

Arsimi është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët ndërmjet moshave 5 dhe 15 vjeç. Këto moshë mund të variojnë pak në disa shtete dhe provinca territoriale. Ju duhet t'i regjistroni fëmijët tuaj në shkollë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Sistemi para-shkollor është i hapur për fëmijët e moshave 3 deri 5 vjeç. Niveli Parashkollor zakonisht është me orar të reduktuar dhe nuk është i detyrueshëm.

Informacioni rreth shkollave lokale merret nga Departamentët e Arsimit të shteteve ose territoreve përkatëse. Detajet mbi kontaktet mund të gjeni tek numërori telefonik lokal.

Kostoja e jetesës në Australi

Kostoja e jetesës në Australi, në krahasim me shumë vende të tjera, është e lartë. Është me rëndësi që ju të mendoni se si do të siguronit për veten dhe familjen tuaj të paktën për 2 vitet e para. Mos e mendoni se mund të gjeni punë shpejt.

Ju nuk duhet të harroni se edhe kostoja e zhvendosjes është e lartë. Do të keni shpenzime të mëdha që përfshijnë udhëtimin për në Australi, lëvizjen e pajisjeve shtëpijake dhe krijimin e një shtëpie të re.

Vazhdon në faqen tjetër ►

Periudha e pritjes Dy-vjeçare për sigurimin social

Shumicës së imigrantëve të sapo ardhur u duhet të jetojnë në Australi për 2 vjet si banorë të përhershëm përpara se të kenë të drejtë të marrin shumicën e pagesave të sigurimit social. Këto përfshijnë ndihmat e papunësisë, (të tilla si Pagesat e Rifillimit ose të Sëmundjes), ndihma për studentët të tilla si Austudy (ndihma financiare për studime) ose Pagesa për të Rinjtë dhe ndihma të tjera si Karta e Kujdesit Shëndetësor. Që të keni të drejtën e pensioneve për të Moshuar dhe për të Paaftë zakonisht duhet që të keni jetuar në Australi 10 vjet si banorë të përhershëm.

Është shumë e rëndësishme që të kuptoni se duhet të keni para të mjaftueshme për të mbajtur vetveten (dhe personat e varur prej jush) gjatë të paktën 2 viteteve të para në Australi. Në qoftë se ju keni sponsor apo një njeri që ju ka garantuar, atëherë ju duhet t'i pyesni ata përpara se të arrini në Australi, rreth përkrahjes që ata janë të gatshëm dhe në gjendje t'ju ofrojnë.

Përrjashtime nga periudha e pritjes

Pagesa e quajtur Ndhimë Speciale mund të jepet gjatë periudhës së pritjes, nëse ju jeni në vështirësi për arsye se ju keni pësuar një ndryshim të madh e përtej kontrollit tuaj në rrethanat tuaja. Kjo pagesë jepet vetëm në raste shumë të rralla. Paaftësia për të gjetur punë apo mbarimi i parave nuk janë arsye të mjaftueshme për kualifikim për Ndhimë Speciale.

Në se ju mbeteni e/i ve, i paaftë apo prind i vetëm pasi keni filluar të jetoni në Australi si banorë të përhershëm, ju mund të keni të drejtë të merrni një pagesë ose pension. Ju gjithashtu mund të merrni pension edhe sikur të mos keni jetuar në Australi për 10 vjet, nëse jeni i mbuluar nga një marrëveshje ndërkombëtare e sigurimit social. Që nga muaji Janar i vitit 2009, Australia ka lidhur marrëveshje për sigurimet sociale me 22 vende të huaja.

Në qoftë se ju jeni imigrant i kategorisë “imigrant me rrethana humanitare”, ose partner ose fëmijë nën kujdesjen e një prindi refugjat; nënshetës Australian, partner ose fëmijë nën kujdesjen e një nënshetësi/e Australian; ose një banor i përhershëm i cili ka jetuar në Australi për 2 vjet, në çfarëdo lloj kohe, ju mund të përjashtoheni nga periudha e pritjes dy vjeçare për shumicën e pagesave të sigurimit social.

Nëse kujdeseni për një person që është banor i/e përhershëm/e dhe keni një vizë të caktuar Kujdestarie juve mund t'ju lejohet që të mos prisni për të marrë pagesën ‘Carer Payment’ (Pagesë Kujdestarie). Po ashtu ju mund të keni të drejtë që të merrni pagesën e quajtur ‘Carer Allowance’ për të cilën nuk duhet të prisni.

Ndhimë për familjet me fëmijë

Imigrantët e rinj me fëmijë mund të kenë të drejtë që të marrin Asistencë Familjare si ndihmë për përbalimin e kostos së rritjes së fëmijëve. Që të keni këtë të drejtë, ju zakonisht duhet të keni vizën e qëndrimit të përhershëm, megjithatë ka disa përjashtime. Për këto pagesa nuk ka periudhë pritjeje. Pagesat e Asistencës Familjare janë vetëm të ardhura suplementare dhe nuk mjaftojnë për të jetuar.

Asistencat Familjare përfshijnë Taksën e Përfitimit Familjar Pjesa A, Taksën e Përfitimit Familjar Pjesa B dhe Rikthimin e Pjesëshëm të Taksës për shpenzimet e prindërve që paguajnë për kopshte dhe çerdhet. Shuma e Taksës së Përfitimit Familjar varet nga moshja dhe numri i fëmijëve në familje dhe nga të ardhurat totale të familjes gjatë vitit. Përfitimet e Kujdesjes së Fëmijës paguhen për tju ndihmuar ju me koston e futjes së fëmijës në çerdhe. Shuma e të hollave që ju do të merrni për Përfitimin për Kujdesje të Fëmijëve, do të varet nga të ardhurat vjetore të familjes tuaj përmbi të ardhurat aktuale të vitit, lloji i çerdes që ju do të zgjidhni (aprovuar apo regjistruar) numri i fëmijëve në çerdhe /kopësht, arsyeja që i dërgoni fëmijët në çerdhe/kopësht dhe se sa orë do t'i lini në çerdhe. Që ju të merrni ‘Child Care Benefit’ (Pagesë për Çerdhe) fëmija juaj duhet t'i ketë marrë të gjitha vaksinimet ose duhet të jetë lejuar që të përjashtohet nga kërkesa e imunizimit.

Që nga 1 Korriku 2008, ‘Child Care Tax Rebate’ (Rikthimi i Pjesëshëm i Taksës për Çerdhe) u rrit nga 30% në 50% të shpenzimeve (kostoja që paguani për kujdesjen e fëmijëve pasi të jetë hequr ‘Child Care Benefit’) për deri në \$7500 (sipas indeksit) për secilin fëmijë çdo vit. Kjo pagesë mund të pagohet çdo tre muaj ose çdo vit. Ju keni të drejtë të merrni ‘Child Care Tax Rebate’ nëse e çoni fëmijën në një qendër të aprovuar, dhe keni të drejtë që të merrni ‘Child Care Benefit’ nëse ju e partneri juaj e kaloni testin e punës, studimeve ose trajnimit. Nëse ju keni të drejtë të merrni ‘Child Care Benefit’, edhe pse sasia e kësaj pagese mund të jetë zero, ju keni të drejtë që të merrni ‘Child Care Tax Rebate’.

Janë gjithashtu edhe 2 lloj asistencash të tjera për familjet me fëmijë të vegjël. Pagesa Shtesë për foshnjat e sapolindur siguron të holla përf t'ju ndihmuar me shpenzimet që sjell lindja e një fëmije. Pagesa e Amësisë për Imunizim është një pagesë e veçantë për familjet me fëmijë të cilët janë të imunizuar krejtësisht ose janë të përjashtuar nga kërkesat e imunizimit.

Në Australi, Zyra e Ndhimës Familjare gjendet brenda të gjitha Zyrave të Medicare, brenda Qendrave të Shërbimeve Publike të Centrelink. Informacione të mëtejshme ju mund të merren nëpërmjet:

Faqja e internetit: www.familyassist.gov.au

Telefoni: 136 150 (në Australi)
131 202 (për informacione në gjuhë të tjera përveç Anglishtes)

Informacionet në lidhje me edukimin e fëmijëve dhe çerdhet gjenden në:

Faqja e internetit: www.mychild.gov.au

Telefoni: 133 684 (në Australi)

Informacione të mëtejshme mbi sigurimin social

Centrelink-u jep kontributin e vet drejt plotësisht të objektivave sociale dhe ekonomike të krijuar nga qeveria, duke siguruar shërbimet për të ndihmuar njerëzit që të mbështetin veten pa ndihmën e të tjerëve dhe përkrahin ata njerëz që kanë nevojë. Në fakt ka shumë rregulla të cilat ndikojnë në të gjitha të drejtat e administruara nga Centrelink. Informacioni i siguruar këtu është vetëm një udhëzim i përgjithshëm dhe ju duhet të diskutoni nevojat e juaja specifike me Centrelink.

Ju mund të gjeni vendodhjen e zyrave të Centrelink dhe numrat e telefonave në numërorin telefonik lokal. Ju mund të flisni me personelin e Centrelink mund të bëni pyetje dhe të merrni përgjigje të përkthyer në gjuhën tuaj duke telefonuar tek 131 202. Ky nuk është një shërbim përkthimi. Telefonatat tek ky numër kushtojnë sa kostoja e një telefonate lokale nga çdo vend i Australisë. Telefonatat e bëra nga telefonat publikë ose prej telefonave celularë mund të jenë me një çmim më të lartë.

Për më tepër informacion rreth pagesave të sigurimeve sociale ose marrëveshjeve ndërkombëtare përpara arritjes suaj në Australi mund të drejtoheni tek:

Faqja e internetit: www.centrelink.gov.au

Adresa Postare: Centrelink International Services
GPO Box 273
HOBART TAS 7001
AUSTRALIA

Telefoni: 131 673 (Shërbimet Ndërkombëtare të Centrelink në Australi)
131 202 (për informacione në gjuhë të tjera përveç Anglishtes)
+613 6222 3455 (jashtë Australisë)
(Shënim: nëse dëshironi që të telefononi tek zyrat e Centrelink nga jashtë vendit, numrat falas mund të merren nga faqja e internetit e Centrelink)

Shëndeti

Qeveria e Australisë siguron ndihmën me shpenzimet mjekësore dhe kujdesit në spital nëpërmjet një programi i cili quhet Medicare. Qeveria gjithashtu subvencionon koston e shumicës së medikamenteve nën Programin e Përfitimeve Farmaceutike (PBS). Medicare dhe PBS janë të administruara nga Medicare Australia.

Për të mësuar në se keni të drejtë për tu regjistruar në Medicare, vizitoni zyren lokale të Medicare me pashaportën, dokumentat e udhëtimit dhe vizën e përhershme. Në qoftë se ju nuk keni vizë të përhershme, ju do të keni nevojë që të siguroni detajet e kërkesës së emigrimit/vizës së përhershme që ju keni kryer.

Shumica e personave që kanë viza të përkohshme nuk kanë të drejtë të regjistrohen për Medicare, megjithatë ka disa përjashtime, për shembull njerëzit që kanë aplikuar për vizë të përhershme dhe plotësojnë kriteret e nevojshme. Ju duhet të vizitoni zyren tuaj lokale të Medicare për të mësuar në se keni të drejtë. Në qoftë se i keni plotësuar kërkesat, ju mund të merrni një numër “të përkohshëm” për kartën Medicare dhe karta arrin në postë pas përafërsisht 3 javësh. Në shumë raste, ju fillimisht do të paguani për kujdesin mjekësor dhe më pas ju kthehet një pjesë e kësaj pagese.

‘Medicare Australia’ administron Regjistrin Australian të Vaksinitimit të Fëmijëve gjatë Fëmijërisë. Në qoftë se keni fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ju lutemi mos harroni të merrni me vete në Australi librezat e vaksinitimit të tyre me qëllim që të ndihmoni doktorin tuaj në Australi që të përcaktojë në se vaksinitimi i tyre është në nivelin e duhur. Kjo është e domosdoshme që më pas të keni të drejtë të merrni disa prej llojeve të pagesave familjare.

‘Medicare Australia’ administron Regjistrin e Dhuruesve të Organeve të Australisë (Regjistri i Dhuruesve). Njerëzit të cilët janë mbi moshën 16 vjeç ose më tepër mund të regjistrojnë dëshirën (ose jo) e tyre për të dhuruar organe në Regjistrin e Dhuruesve. Për njerëzit që kanë sëmundje serioze ose sëmundje kërcënuese për jetën, transplantimi i organeve mund të japë një shanc të dytë për jetën.

Përveç kësaj, ‘Medicare Australia’ siguron gjithashtu ndihmë dhe shërbime me pagesat e Asistencës Familjare. Disa prej këtyre pagesave që janë të disponueshme tek zyra lokale e Medicare përfshijnë: Përfitimet e Taksës Familjare, Pagesën “Baby Bonus” kur lind një fëmijë, Përfitimet e Kujdesit për Fëmijët, Pagesat e Lejes së Lindjes dhe Pagesa për Imunizimin për nënën gjatë shtatzanisë dhe kohës pas Lindjes.

‘Medicare Australia’ ka një paketë informacioni e cila është përkthyer në 19 gjuhë dhe është e disponueshme në Anglisht me gërma të mëdha, Braille (system i të shkruajturit për të verbërit) dhe në audio kompakt disk (CD) si dhe kasetë. Kjo paketë ka informacion rreth shërbimeve të ‘Medicare Australia’ dhe shpjegon kërkesat për të patur të drejtën për këto përfitime dhe pagesa. Kopje të kësaj pakete janë të disponueshme nga faqja e internetit ‘Medicare Australia’, ose nga zyra lokale ‘Medicare.’

Për më tepër informacione:

Faqja e internetit: www.medicareaustralia.gov.au
E-mail: info@medicareaustralia.gov.au
Telefonit: 132 011* – Medicare
1800 020 613** – Skema e Përfitimeve Farmaceutike
1800 653 809** – Regjistri i Australian i Vaksinitimit të Fëmijëve
1800 777 203** – Regjistri i Dhuruesve të Organeve në Australi
1800 552 152** – Për personat që kanë vështirësi për të dëgjuar dhe folur.
131 450* – Shërbimi i Përkthimit dhe Interpretimit

Adresa Postare: Medicare Australia
GPO Box 9822
Në kryeqytetin tuaj

Sigurimet Shëndetësorë Private.

Shumë Australianë zgjedhin opsionin e sigurimeve shëndetësore private. Ato mbulojnë disa ose të gjitha trajtimet si një pacient privat në spitalin private ose publike, dhe mund të përbajnë disa shërbime shtesë që Medicare nuk i mbulon, si për shembull shërbimet dentare, shumicën e shërbimeve optike dhe transportimi me ambulancë. Në se mendoni të paguani për të qenë të siguruar për shërbime shëndetësore nga një institucion privat, duhet të keni parasysh 3 rregulla të qeverisë.

1. Rikthimi i Parave për Shpenzimet e paguara prej 30% - Ju keni të drejtë që t’u kthehet 30% e parave të paguara për një shërbim shëndetësor të përgjithshëm (të zakonshëm apo ekstra) ose spitalor në rast se keni kartën Medicare dhe kanë një siguracion shëndetësor që e pranon këtë Rikthim të Parave. Rikthimi ju jep rreth 30% të koston totale të siguracionit shëndetësor privat (Për njerëz nga moshë 65-69 Rikthimi është 35% dhe për njerëz 70 vjeç e sipër, Rikthimi është 40%.
2. “Medicare Levy Surcharge” (Tatim i Medicare-s mbi tatimin e zakonshëm) – Shumica e Australianëve që paguajnë taksa kanë tatimin “Medicare Levy” që duhet të paguhet i përfshirë në sasinë e taksave vjetore. Mbi-tatimi është një shtesë tatimi prej 1% që u vihet personave që fitojnë më shumë se një nivel i caktuar të ardhurash dhe që s’kanë siguracion privat spitalor. Nivelet e caktuar të të ardhurave janë: \$70,000 për një person tek dhe \$140,000 për çiftet dhe familje. Këta kufinj rriten gradualisht çdo vit sipas rritjes së pagave mesatare.
3. “Lifetime Health Cover” – është një skemë financiare që mund të paguhet si shtesë e tarifës normale bazë për siguracionin privat spitalor. Për të mos e paguar LHC ju duhet të të merrni siguracion spitalor përpara afatit të skadimit që zakonisht është data 1 Korrik pas ditëlindjes së 31-të. Por si imigrant i sapoardhur në Australi afati për ju mund të jetë më vonë në varësi të moshës që keni kur hyni në Australi.

Në se e merrni sigurimin spitalor pas afatit të caktuar ju duhet të paguani LHC që është 2% mbi tarifën për çdo vit që ka kaluar pas moshës 30 vjeçare. Për shembull, në se prisni deri në moshën 40 vjeçare ju mund të pagoni rreth 20% më shumë për koston e siguracionit spitalor.

Për imigrantët e rinj në Australi që janë mbi moshën 31 vjeçare, nuk paguhet një kosto më e madhe në se fillojnë të paguajnë sigurimin spitalor brenda 12 muajve që nga dita që regjistrohen për Medicare, si njerëz që ju takon me ligj. Është me rëndësi të mbahet në konsideratë pagimi i sigurimit spitalor gjatë vitit të parë pasi të regjistroheni me Medicare. Në se prisni më shumë se 12 muaj, pas regjistrimit me Medicare, atëherë do t’ju duhet të paguani LHC përveç tarifës. Në se jeni nën moshën 31 vjeçare kur arrini në Australi, atëherë afati juaj do të jetë si gjithë të tjerët (1 Korrik pas ditëlindjes së 31-të)

Më shumë informacion për siguracionin privat mund të merret në

Faqja e internetit: www.privatehealth.gov.au

E-mail: privatehealth@health.gov.au

Postojeni: MDP 66
Private Health Insurance Branch
Department of Health and Ageing
GPO Box 9848
CANBERRA ACT 2601
AUSTRALIA

Vazhdon në faqen tjetër ►

* Sipas tarifave për telefonatat

** Sipas tarifave telefonike për celularët dhe kabinat telefonike

Punësimi në Australi

Tregu i punës në Australi është shumë konkurrues. Punësimi në Australi varet nga faktorët ekonomikë, lloji i punës që kërkohet dhe rrethanat specifike të cilat mund të ndikojnë në vendet e lira të punës në çdo kënd të vendit. **Pranimi i imigrimit nuk garanton punë**, bile dhe për ata kërkesë-bërës të cilët janë vlerësuar si me aftësi të larta në zanatin e tyre.

Që nga Dhjetori 2008, përqindja e papunësisë në Australi ishte 4%. Imigrantët që kanë ardhur nga periudha Nëntor 1997 deri në 2007 janë vlerësuar që të kenë një përqindje papunësie rreth 5% (informacioni origjinal). Në Dhjetor 2008, imigrantët që kanë lindur në vendet ku flitet Anglishtja, përqindja e papunësisë ishte 4%, ndërsa përqindja për ata që kanë lindur në vende të tjera ishte 5.7%. Përgjithësisht, imigrantët që janë vendosur prej shumë kohësh në Australi kanë përqindjen e papunësisë të ulët në përgjithësi. Njëkohësisht, ata që kanë hyrë në Australi nën kategorinë e Zanateve kanë në përgjithësi përqindjen e papunësisë më të ulët sesa emigrantët e ardhur nën kategoritë e tjera.

Për të mësuar më shumë rreth perspektivës për të gjetur punë, lexoni gazetën Australiane, sidomos botimet e ditës së Mërkurë dhe të Shtunë, të cilat përmbajnë njoftimet e punësimit.

Përpara se të niseni për në Australi ju duhet të mësoni në se ju duhet të plotësoni ndonjë kërkesë apo kusht të veçantë për të gjetur punën që dëshironi. Për shumë punë në Australi, aplikuesit kanë mundësi të regjistrohen ose të marrin licensë pranë Autoriteteve të Shtetit ose territorit Australian, dhe / ose mund të pranohen për anëtarësi në një organizatë profesionale ose Industriale.

Ju duhet të mësoni në se për të punuar në zanatin tuaj ju duhet që të keni një regjistrim të caktuar apo licensë. Edhe personat e varur prej jush duhet të marrin të dhëna në lidhje me perspektivën që kanë për të gjetur punë, pavarësisht se ata nuk mund të kenë për qëllim që të kërkojnë punë menjëherë mbas mbërritjes.

Ata imigrantë që nuk kanë gjetur punë duhet të regjistrohen me Centrelink sa më shpejt mbas mbërritjes që të jetë e mundur. Meqënëse imigrantët e sapoardhur nuk kanë të drejtë që të marrin pagesat e sigurimit social për 2 vjet pas mbërritjes, ata mund të kenë të drejta të kufizuara në lidhje me marrjen e shërbimeve të punësimit të financuara nga Qeveria nëpërmjet anëtarëve të Job Network (Rrjeti i Punës). Megjithatë, ata imigrantë që janë banorë të përhershëm dhe plotësojnë kriteret e tjera të pranimit, do të jenë në gjendje që të përdorin gamën e plotë të shërbimeve të Job Network (Rrjetit të Punës).

Programi i punësimit, informacioni i kërkimit të punës dhe njohjes së aftësive është i disponueshëm në faqet e mëposhtme të internetit :

- Kërkimi për punësim në Australi (Informacion mbi punësimin, perspektivat e punës, mungesa e zanateve dhe karriera në Australi) www.jobsearch.gov.au
- Zyra e Punësimit në Australi (për informacione rreth vendeve të punës në Australi) www.workplace.gov.au
- Imigrantët me Zanat (për aplikuesit kryesore në kategoritë e zgjedhura të Zanateve/kualifikimeve me Listën e kualifikimeve të kërkuara për Punësimin e Imigrantëve) www.skilledmigrant.gov.au
- Organizata e Njohjes së Zanateve në Australi (Për Njohjen e Kualifikimit) www.workplace.gov.au/tra
- Informacion për Njohjen e Aftësive në Australi (për njohjen e kualifikimeve dhe zanateve nga vende të tjera) www.immi.gov.au/asri

Taksa e të Ardhurave

Banorët e Australisë paguajnë taksa për të ardhurat e tyre nga çdo vend në botë. Ata duhet të deklarojnë të gjitha të ardhurat e tyre nga Australia ose ndonjë vend tjetër. Në se keni të ardhura nga një vend jashtë Australisë, ju këto të ardhura duhet t'i deklaroni kur plotësoni dokumentet e taksave, edhe sikur të keni paguar taksë në vendin ku janë fituar të ardhurat. Në se ju duhet të paguani taksa në Australi edhe për të ardhurat nga shtetet e tjera, dhe ju keni paguar taksë për këto të ardhura në atë vend, atëherë ju mund të keni të drejtë që të përjashtoheni nga pagimi i taksës për të, në Australi.

Numri i dosjes së taksave (TFN) është një numër unik i lëshuar nga Zyra Australiane e Taksave për çdo individ dhe organizatë për qëllime identifikimi dhe shënim mbajtjeje. Në përgjithësi, në se dëshiron që të punësohesh në Australi, pavarësisht nga mosha, është në të mirën tënde që të aplikosh për një TFN. Ndryshe, në se nuk keni TFN, punëdhënësi është i detyruar që të mbajë 46.5% të rrogës suaj. Për të marrë TFN, mund t'i telefononi Zyrës së Taksave që t'ju dërgojnë një formular. Ose TFN mund të merret edhe tek faqja e internetit të Zyrës së Taksave 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Për më shumë informacion

Faqja : www.ato.gov.au

Telefoni: 132 861 (në Australi)

Shërbimet e Qëndrimit për Komunitetin e Emigrantëve

Departamenti i Imigracionit dhe Nënshetësisë siguron një numër shërbimesh të stabilizimit në Australi të qëndrimit për të ndihmuar emigrantët dhe personat e pranuar mbi baza humanitare që të bëhen pjesëmarrës aktivë në komunitetin Australian sa më parë që të jetë e mundur mbas arritjes së tyre. Departamenti i Imigracionit dhe Nënshetësisë siguron fonde për organizata të komunitetit nën Programin e Ndhimave për Stabilizim. Listën e organizatave që ofrojnë Shërbime për Stabilizimin e Imigrantëve në Komunitetin e gjerë mund ta shikoni tek www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/find-help/where-to-help/

Për ata imigrantë që e kanë këtë të drejtë, organizatat që ofrojnë Shërbime për Stabilizimin mund të japin informacione se si të gjenden banesat, çerdhet, punësimi dhe shkollat, etj. Ata mund t'ju lidhin edhe me rrjete të përkrahjes që mund t'ju vijnë në ndihmë që të stabilizoheni sa më mirë.

Ndihma dhe mësimi i gjuhës

Departamenti i Imigracionit dhe Nënshetësisë siguron 2 shërbime të rëndësishme për imigrantët që kanë nevojë për ndihmë me gjuhën. Ata janë Programi i Anglishtes për Imigrantët e Rritur (AMEP) dhe Shërbimi i Përkthimit dhe Interpretimit. (TIS National).

Programi i Anglishtes për Emigrantët e Rritur (AMEP)

Mësimi i gjuhës Angleze është një nga hapat e parë dhe më të rëndësishëm që mund të merren drejt stabilizimit në Australi dhe drejt arritjes së synimeve personale, shoqërore dhe ekonomike. Në se keni të drejtë, ju mund të ndiqni programin e AMEP që siguron mësimet bazë të gjuhës Angleze për t'ju mësuar që të komunikoni në jetën e përditshme dhe në disa situata në vendin e punës.

Në se keni të drejtë për AMEP, ju mund të merrni 510 orë mësimi falas ose derisa të arrini në nivelin funksional të gjuhës (varet se cili kusht plotësohet më shpejt). Në se keni ardhur me vizë humanitare dhe keni patur përvoja të vështira si trauma apo tortura, ose në se nuk jeni të mirë-arsimuar ju mund të keni të drejtë që të merrni më shumë mësim.

Regjistrimi duhet të kryhet brenda tre muajve që nga ardhja në Australi ose marrja e lejes për të banuar në Australi. Mësimi duhet të nisë brenda vitit të ardhjes ose ju mund të humbni të drejtën për të mësuar Anglisht me AMEP. Pas regjistrimit, fillimi i mësimëve mund të shtyhet nëse keni arsye familjare, punë apo përgjegjësi të tjera.

AMEP ka disa lloje mësimdhënieje. Ju mund të shkoni në shkollë me orar të zgjatur, të shkurtër ose mund të mësoni edhe në shtëpi me korespondencë ose me një tutor. Nëse fëmijët janë të vegjël ju mund t'i çoni në çerdhe falas gjatë kohës që jeni në mësim.

Kontaktoni Departamentin e Imigracionit dhe Nënshtrësisë në 131 881 ose vizitoni AMEP në www.immi.gov.au/amep për të parë nëse mund të mësoni me AMEP dhe se ku mund të regjistroheni.

Shërbimi i Përkthimit dhe Interpretimit (TIS National)

Shërbimi Kombëtar i Përkthimit “TIS National” ju ofron përkthyes në telefon në më shumë 160 gjuhë dhe dialekte dhe është i hapur 24 orët e ditës, 7 ditët e javës si dhe për situatat e urgjencës. Nëse dëshironi të flisni me dikë në gjuhën tuaj, TIS mund t'ju ndihmojë. Po ashtu mund t'ju ndihmojë në raste urgjente nga kudo në Australi.

Kur keni nevojë për një përkthyes, ju duhet t'i telefononi TIS National në 131 450. Ose këtë mund ta bëjë për ju edhe departamenti qeveritar, biznesi ose shërbimi komunitar me të cilin keni nevojë që të bisedoni.

TIS National jep shërbime mbi bazën e tarifave, megjithatë në shumicën e rasteve kostoja e përkthyesit paguhet nga departamenti qeveritar, biznesi ose shërbimi komunitar.

Nëse keni nevojë për ndihmën e një përkthyesi kur të bëni konsultë me mjekun, mund t'i kërkonti mjekut ti telefonojë TIS-it Kombëtar në numrin e Prioritetit për Mjekët, për të siguruar përkthyes me telefon. Mjeku mund të marrë një përkthyes të pranishëm në vizitë nëse ka nevojë. Edhe farmacistë mund të marrin përkthyes nëse kanë nevojë që të bisedojnë me ju.

Përkthimi në gjuhën Angleze i dokumentëve personalë (çertifikata lindjeje ose martese, patenta, dokumente arsimore ose punësimi) është falas për imigrantët përgjatë dy vjetëve të para të vendosjes në Australi. Për më shumë informacion shkoni tek

www.immi.gov.au/living-in-australia/help-with-english/

TIS National i mirëpret kërkesat nga banorët e përhershëm dhe nënshtrësit Australiane që janë të interesuar të bëhen përkthyes me kontratë për të siguruar shërbimet e përkthimit për anëtarët e komunitetit Australian. Në qoftë se jeni të aftë në Anglisht dhe së pakut në një gjuhë tjetër, mund ta merrni në konsideratë të bëheni përkthyes me kontratë me TIS National. Ju lutemi që të kontaktoni një nga Menaxherët e ‘TIS National’ për Kontrata në numrin 1300 132 621 për më shumë informacion në lidhje me punësimin si përkthyes dhe kushtet e punës.

Programet e Anglishtes të Departamentit të Arsimit, Punësimi dhe Marëdhënëve në Punë, (DEEWR)

Mësimi i Gjuhës Angleze, shkrimi dhe këndimi si dhe numërimi gjithashtu mund të kryhet nëpërmjet programeve specifike që drejtohen nga Departamenti i Arsimit, Punësimi dhe Marëdhënëve në Punë, (DEEWR) si dhe nëpërmjet qeverive Shtetërore dhe Territoriale të Australisë. DEEWR ka dy 2 programe për mësimin e gjuhës Angleze dhe numërimin për klientët të moshës së aftë për punë (15-64 vjeçarët).

Programi i parë është (LLNP) i cili është programi i gjuhës, leximi dhe numërimi dhe ofron 800 orë të mësimi të gjuhës me qëllim gjetjen e punësimit për personat që kërkojnë punë dhe që kanë të drejtë që t'i marrin keto orë mësimi. Programi LLNP ka për qëllim përmirësimin e aftësive gjuhësore, dhe /apo të leximit, këndimit, numërimin në mënyrë që për t'i ndihmuar ata që të sigurojnë punësim afatgjatë ose që t'ju hapen dyert për të vazhduar arsimimin apo trajnimin e mëtejshëm. Programi ofron trajnim të specializuar nëpërmjet Trajnimit Plotësues që ka për qëllim përkrahjen e personave me disavantazhe.

E dyta është programi (WELL) që është Programi i Gjuhës, Lexim-Këndimit për në Vendin e Punës, që siguron fondet për organizatat për trajnimin e punëtorëve në Gjuhën Angleze, lexim-këndim dhe numërim, për t'i ndihmuar në plotësimin e nevojave tyre në të ardhmen për punësim dhe trajnim.

Qeveria Australiane gjithashtu ofron fonde për të ndihmuar qeveritë Shtetërore dhe Territoriale të Australisë dhe autoritetet e arsimit jo-qeveritar që të japin mësim intensiv të gjuhës Angleze për studentët e porsaardhur të moshës së shkollës fillore dhe të mesme, të cilëve ju takon me ligj të marrin pjesë nën ombrellën e programit (ESL-NA) që është Mësimi i Anglishtes si Gjuhë e Dytë. Qëllimi i këtij programi është që të përmirësojë kushtet e arsimit për studentët e porsaardhur që nuk flasin Anglishten dhe t'u mundësojë atyre suksesin duke i zhvilluar dhe duke i ndihmuar që të marrin pjesë në aktivitetet arsimore njësoj si nxënësit e tjerë.

Pritet që ata studentët që kanë të drejtë të mësojnë, të vazhdojnë mësimin e Anglishtes në mënyrë intensive për të paktën 6 muaj në qendrat të mësimi intensiv të Anglishtes, nëpër shkolla apo vende të tjera të caktuara. Secili juridiksion mban përgjegjësi për caktimin e metodave të nevojshme në lidhje me vlerësimin e nevojave që kanë nxënësit, për programin e mësimi “ESL” si dhe për mësimdhënien intensive të Gjuhës Angleze.

Për informacione të tjera:

Faqja e internetit: www.deewr.gov.au

Telefoni: 1300 363 079

Nënshtrësitë Australiane

Informacione rreth Nënshtrësisë Australiane, duke përfshirë edhe “kujt i takon” si dhe formularët e kërkesë-bërjes, gjenden në faqen e internetit për nënshtrësinë: www.citizenship.gov.au ose duke marrë në telefon linjën për informacion rreth nënshtrësisë: 131 880 brenda Australisë.

Vazhdon në faqen tjetër ►

Keni nevojë për më tepër informacion apo këshillë

Mos harroni që të merrin një kopje të broshurës “Fillimi i Jetës në Australi” për shtetin ose territorin ku keni ndërmend të banoni. Ato janë të disponueshme në Anglisht dhe 37 gjuhë të komunitetit, dhe gjenden në internet:

www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/

Informacionet dhe këshillat e qëndrimit mund të merren nga zyrat e Departamentit të Imigracionit dhe Nënshitetësisë në Australi dhe jashtë kufijve të Australisë. Për informacione të mëtejshëm shkoni tek:

Departamenti i Imigracionit dhe Nënshitetësisë

Telefoni: 131 881 (pyetje të përgjithshme brenda Australisë)

www.immi.gov.au

Informacion mbi emigrimin në Australi

www.immi.gov.au/migrants/

Informacioni mbi jetën në Australi

www.immi.gov.au/living-in-australia/

Lista e Zyrave të Imigracionit jashtë Australisë

www.immi.gov.au/contacts/overseas/

Lista e shërbimeve brenda Programit të Ndihmave të Qëndrimit

www.immi.gov.au/living-in-australia/settle-in-australia/find-help/where-to-help/

Faqja e internetit për nënshitetësinë

www.citizenship.gov.au

Informacione të Mëtejshme

Shërbimet e Urgjencës

(Zjarri, Policia, Ambulanca) – 24 orë

Telefoni: 000

Shërbimi i Përkthimit dhe Interpretimit (TIS National)

Telefoni: 131 450

www.immi.gov.au/tis/

Shërbimi i Informacionit Rajonal i Qeverisë Australiane

Telefoni: 1800 026 222

www.regionalaustralia.gov.au

Faqja e Informacioneve për Njohjen e Aftësive në Australi

www.immi.gov.au/asri

AEI-NOOSR (informacione të përgjithshme në lidhje me njohjen e aftësive të fituara jashtë vendit)

Telefoni: 1300 363 079

www.aei.gov.au

Faqja e internetit e Qeverisë Australiane

www.australia.gov.au

Adresa e Internetit

www.immi.gov.au

Linja e përgjithshme e pyetjeve

Telefoni **131 881** gjatë orarit zyrtar të punës në Australi që të flisni me operatorin (informacioni i regjistruar është i disponueshëm jashtë orarit të përmendur më sipër). Në qoftë se ju jeni jashtë Australisë, lutemi kontaktoni zyrën e përfaqësisë më të afërt Australiane.